REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 18, datë 27.11.2024

PËR
MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: "KOMPLEKS TURISTIK, REZIDENCIAL DHE HOTELERI "GIRASOLE ZEEN RESORT" ME 3 KATE MBI TOKË DHE 2-3 KATE NËNTOKË, ME VENDNDODHJE NË JALË, BASHKIA HIMARË

Në mbështetje të neneve 27, 28, 39 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit", i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues "Elda - Vl" sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: "Kompleks turistik, rezidencial dhe hoteleri "Girasole Zeen Resort" me 3 kate mbi tokë dhe 2-3 kate nëntokë, me vendndodhje në Jalë, Bashkia Himarë, me subjekt zhvillues "Elda - Vl" sh.p.k.

2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë i bashkëlidhen këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.

3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
   a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
   b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Himarë.

4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.

5. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit, hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I
E D I R A M A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE I MINISTRAVE

MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT

BLENDI GONXHJA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - MINISTRIA E TURIZMIT KULTURËS DHE SPORTIT - TIRANË

ANËTAR / SEKRETAR I KKTU-SË

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT - KRYEMINISTRIA

Nënshkruar më datë 20 /01/ 2026